



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së:	KBI "Agrokultura" Gjilan, ("Ndërmarrja") PIP "Mladost" Gnjilane,
Emri i Ndërmarrjes së Re:	Ndërmarrja e Re Depoja Frigoriferi Shillovë Sh.P.K ("Ndërmarrja e Re")
Vendndodhja:	Fshati Shillovë në Komunën e Gjilanit
Biznesi/Spektori:	Industria Agro Ushqimore
Prodhimet:	Shërbimi kryesor i ndërmarrjes është ruajtja në të ftohtë e mishit, frutave, perimeve dhe akulloreve. Objekti i depozitimit frigoriferik përbëhet nga 6 dhoma frigoriferike, me vëllim total prej 12880 m³. Temperatura mund të rregullohet ndaras për çdo dhomë. Depoja Frigoriferike po ashtu merret edhe me përpunimin dhe paketimin e frutave dhe perimeve (qersh, kumbulla, kërpudha, speca, domate, luleshtrydhe, etj) për ruajtje në të ftohtë ose për shpërndarje.
Tregu:	Treg i natyrshëm për Depon Frigoriferike janë agrokombinatet dhe prodhuesit e mishit, frutave dhe perimeve në rajon. Depoja Frigoriferike po ashtu ka ofruar shërbime për klientët e vegjël në tërë Kosovën si qendër logjistike për distribuimin e mishit, akullores dhe frutave të importuara.
Konkurrenca:	Depoja Frigoriferike është e vetmja e këtij lloji në pjesën lindore të Kosovës. Një e ngjashme është në Nish (Serbi) dhe një me kapacitet të vogël në Prizren.
Punonjësit:	Ndërmarrja për momentin ka katër punëtorë. Sidoqoftë, asnjëri nga këta punëtor nuk do të bartet tek Ndërmarrja e Re.
Ndërtesat dhe tokat:	Kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë një objekt njëkatësh 4322m ² , si dhe tokën përcjellëse 9878m ² , që së bashku përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 14200m ² . Lokacioni është mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloji biznesi.
Detyrimet që do të barten:	(1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

Rr. E Bujanovcit PN
(f-ika baterive IBG)
60 000 Gjilan, Kosovë,
Tel: 0280 328 444,
Fax: 0280 326 000
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
 - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-së.

**Fotoja e
Ndërmarrjes së Re**

Depoja Frigoriferi



Informatat:

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255
Fax: + 381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushevcu Nr.8
10000 Pristinë, Kosovë

Rr. E Bujanovcit PN
(f-ika baterive IBC)
60 000 Gjilan, Kosovë,
Tel: 0280 328 444,
Fax: 0280 326 000
www.pak-ks.org